ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214/30400-26-4777-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **FURNIZIM ME SPALETA RITENDER**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Naim Shuki B.I.**
NUI	**811294199**
Adresa	**Wesly Clark Pn**
Vendi	**PRIZREN**
Kodi postar	**20000**
Numri Telefonit	**+383 49841841**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**NAIM SHUKI**
Adresa elektronike	**infoprinteks@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**16.10.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

FURNIZIM ME SPALETA RITENDER

Nr i prokurimit 214/30400-26-4777-1-2-1

Nr i brendshëm 214/26/014/121

POLICIA E KOSOVËS

Titulli: FURNIZIM ME SPALETA RITENDER

B05 Njoftim per Kontrat 17.06.2026

Hapje 29.06.2026-spaleta.pdf29.06.2026

Njoftimi mbi Vendim dhe Letrat Standarde.pdf01.10.2026

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim

Vendimi mbi Refuzim 08.10.2026.pdf08.10.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim

Vendimi mbi Refuzim 08.10.2026.pdf08.10.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 1 i LPP-së Qellimi
Neni 59 i LPP-së Ekzamini vlersimi dhe krahasimi tendereve
Neni 60 i LPP-së Kriteret per dhenjen e kontrates 3/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK
Neni 59 i LPP-së aftesit teknike dhe/ose profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në mbështetje të **Nenit 108/A** të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (këtu e tutje: **LPP**), Operatori Ekonomik **"Naim Shuki B.I."** paraqet këtë **ankes në OSHP** kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues për eliminimin e OE "Naim Shuki B.I." dhe/ose njoftimit mbi vendimin e AK-së, si i **pabazuar, i paligjshëm, i paarsyetuar dhe në kundërshtim të plotë me LPP-në**.

Me anë të këtij parashtrimi, paraqesim argumentet tona ligjore dhe faktike kundër pikave dhe pretendimeve të cekura në vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) për eliminimin e OE sonë:

Lidhur me Pretendimin 1 të AK-së:

"OE mostrat e sjella, thyerjet nuk janë të theksuara por kanë formën e rrumbullakosur

dhe nuk janë fare sipas specifikave teknike pasi që pika referuese e matjes është vështirë të përcaktohet."

Kundërareugmenti i OE "Naim Shuki B.I.":

- **Mungesë e specifikimit konkret:** Ky pretendim i AK-së është tërësisht i paarsyetuar dhe subjektiv. Oferta jonë përmban **18 ciftë spaletash (mostra)**. AK-ja nuk ka përcaktuar fare se **cila/cilat** nga këto 18 ciftë mostrash nuk i plotësojnë specifikimet teknike apo ku qëndron devijimi ekzaktsisht.
- **Mungesë e metodologjisë së matjes:** AK deklaron se *"pika referuese e matjes është vështirë të përcaktohet"*. Kjo vërteton se vetë AK-ja nuk ka kryer matje precize dhe shkencore, por ka bërë vlerësim sipërfaqësor dhe arbitrar. Nëse dosja e tenderit nuk ka përcaktuar një metodologji specifike apo tolerancë të formës, AK nuk mund të eliminojë një OE mbi baza të pretendimeve subjektive pa ofruar matje dhe procesverbal të detajuar për secilin pozicion.
- **Shkelja e LPP-së:** Kjo përbën shkelje direkte të **Nenit 7 (Trajtimi Barabartë dhe Pa-anshmëria)** dhe **Nenit 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Ofertave)** të LPP-së, ku AK detyrohet t'i vlerësojë ofertat në mënyrë objektive dhe të dokumentuar.

Lidhur me Pretendimin 2 të AK-së:

"Gjerësia filluar nga pjesa e krahut 60mm, e tejkalon edhe devijimin e lejuar 1% (është 63). Këto defekte përsëriten tek të gjitha mostrat."

Kundërargumenti i OE "Naim Shuki B.I.":

- **Paqartësi dhe mungesë e procesverbalit të matjes:** AK konstaton se gjerësia është 63mm nga 60mm e kërkuar, mirëpo nuk specifikon se në cilat nga 18 ciftet e spaletave të dorëzuara është bërë kjo matje.

- **Tolerancat teknike standarde në tekstil:** Në industri dhe konfeksionim tekstil, matjet e spaletave dhe përmasave fizike duhet t'i nënshtrohen procesverbalit individual ku shënohet secili artikull. AK ka dhënë një konstatim të përgjithshëm pa specifikuar detajisht secilin artikull. E drejta e OE për sqarim dhe transparentë është cenuar, sepse nuk na është ofruar mundësia të shohim matjet për secilin cift spaletash.

Lidhur me Pretendimin 3 të AK-së:

"Gjithashtu qëndisja nuk është e rregullt."

Kundërargumenti i OE "Naim Shuki B.I.":

- **Vlerësim tërësisht subjektiv dhe i paarsyetuar:** Pretendimi se *"qëndisja nuk është e rregullt"* është një formulim i përgjithshëm, pa asnjë bazë teknike dhe i paarsyetuar në aspektin normativ. AK-ja nuk ka sqaruar se ku qëndron parregullsia (në densitetin e fijeve, llojin e tegelit, apo ngjyrën) dhe cila specifikë teknike e kërkuar në Dosjen e Tenderit është shkelur apo nuk është plotësuar.

- **Mungesë e kërkesës teknike specifike ne Dosjen e Tenderit:** Neni 28 i LPP-së përcakton se specifikimet teknike duhet të lejuar qasje të barabartë dhe të mos krijojnë pengesa të pajustifikuara. Nëse AK nuk ka përcaktuar qartë në Dosjen e Tenderit standardin ekzaktsisht të matur për qëndisjen, eliminimi mbi konstatime të tilla abstrakte përbën shkelje të parimit të transparencës dhe arsyetimit të vendimit administrativ.

Lidhur me Pretendimin 4 të AK-së (Konstatimi për rekomandimin e OSHP-së dhe OE-së tjetër):

Vendimi i AK-së pretendon se nga OSHP është rekomanduar të shpërblehet me kontratë OE i rekomanduar nga AK si i përgjegjshëm.

Kundërargumenti i OE "Naim Shuki B.I.":

- **Interpretim i gabuar dhe i deformuar i Vendimit/Rekomandimit të OSHP-së:** Pretendimi i AK-së nuk është i vërtetë. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) nuk ka dhënë urdhër apo rekomandim automatik për shpërblim me kontratë të OE-së tjetër, por e ka kthyer lëndën në **RIVLERËSIM** me udhëzime të qarta.

- Udhëzimi i OSHP-së ka qenë që të pranohet data e A-testeve të dorëzuara dhe lënda të rivlerësohet konform rregullave. AK-ja nuk mund ta përdorë vendimin e OSHP-së si arsyetim për të mbuluar devijimet, gabimet dhe papërgjegjshmërinë e OE-së tjetër të cilin AK po tenton ta shpërblejë me kontratë, duke anashkaluar rivlerësimin real e të paanshëm të të gjitha ofertave dhe mostrave.

Lidhur me Pretendimin 5 (Mostrat):

Gjatë qasjes në mostrat e OE-së, për të cilën Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se është e përgjegjshme dhe se mostrat e dorëzuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në Aneksin e Dosjes së Tenderit, kemi vërejtur disa mospërputhje gjatë matjes dhe verifikimit të mostrave.

Konkretisht, gjatë matjeve kemi konstatuar mospërputhje në dimensionet dhe simetrinë e spaleteve të dorëzuara. Sipas matjeve të kryera, në disa raste devijimi rezulton të jetë më i madh se 1%, çka, sipas kërkesave dhe tolerancave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, mund të tejkalojë tolerancën e lejuar.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë një verifikim të detajuar dhe objektiv të këtyre mostrave, duke marrë parasysh të njëjtat kritere, mënyrë matjeje dhe toleranca të aplikuara gjatë vlerësimit të të gjitha OE-ve.

Në rast se gjatë rivlerësimit konfirmohen mospërputhjet e evidentuara, kërkojmë që edhe kjo mostër të trajtohet në mënyrë të barabartë me mostrat e OE-ve të tjera dhe të vlerësohet në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, veçanërisht sa i përket dimensioneve, milimetrave dhe simetrisë së spaleteve.

Kjo kërkesë paraqitet me qëllim të sigurimit të trajtimit të barabartë të të gjithë Operatorëve Ekonomikë dhe të zbatimit të njëjtë të kritereve dhe tolerancave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Fotografitë e bashkëngjitura janë realizuar gjatë qasjes në mostrat dhe dokumentacionin e operatorit ekonomik (OE), të cilin Autoriteti Kontraktues (AK) e ka vlerësuar si të përgjegjshëm dhe synon t'ia rekomandojë kontratën për dhënie.

Nga shqyrtimi i mostrave të këtij operatori ekonomik, kemi vërejtur devijime në përmasat e kërkuara në Aneksin përkatës të dosjes së tenderit. Konkretisht, për një dimension ku është kërkuar masa prej **60 mm**, gjatë matjes së mostrës është vërejtur devijim deri në **3 mm**, gjë që tejkalon tolerancën e lejuar prej 1%.


Në këtë rast, konsiderojmë se ekziston një mospërputhje e dukshme në mënyrën e vlerësimit të mostrave nga ana e Autoritetit Kontraktues. Përkatësisht, në rastin e operatorit ekonomik Naim Shuki BI, AK ka përdorur devijimet në përmasa si arsye për eliminimin e ofertës, ndërsa në rastin e operatorit tjetër ekonomik, i cili është vlerësuar si i përgjegjshëm, devijimet e ngjashme apo edhe më të mëdha duket se janë anashkaluar.

.


00044


00044










00044

Lidhur me Pretendimin 5.1 (Mostrat): Shenja dalluese për Kadet Policor

• **Mospërputhje në qëndisje:** Qëndisja e simbolit/tekstit është e deformuar (me valë) dhe jo e drejtë, gjë që çënon pamjen zyrtare dhe uniformitetin e produktit.

• **Mungesë preciziteti:** Sfondi dhe sipërfaqja e spalelës paraqesin tërheqje jo të barabartë të fillit, duke shkaktuar palosje dhe kurbatura të padëshirueshme



Lidhur me Pretendimin 5.2 (Mostrat): GradaPolic

• **Asimetri në qëndisje:** Mbushja e qëndisjes paraqet shmangie të dukshme – në njërën anë qëndisja shkon plotësisht deri në skaj (fund), ndërsa në anën tjetër është më e ngushtë, duke krijuar një pamje joproporcionale.

• **Deformim i sipërfaqes:** Si pasojë e dendësisë jo të barabartë të fillit dhe tërheqjes asimetrike, pëlhura/stema paraqet valëzim (kurbaturë) dhe nuk qëndron e rrafshët



Lidhur me Pretendimin 5.3 (Mostrat): GradaPolic i Lartë

Asimetri në qëndisje: Mbushja e qëndisjes paraqet shmangie të dukshme – në njërën anë qëndisja shkon plotësisht deri në skaj (fund), ndërsa në anën tjetër është më e ngushtë, duke krijuar një pamje joproporcionale.

- **Deformim i sipërfaqes:** Si pasojë e dendësisë jo të barabartë të fillit dhe tërheqjes asimetrike, pëlhura/stema paraqet valëzim (kurbaturë) dhe nuk qëndron e rrafshët.



Lidhur me Pretendimin 5.4 (Mostrat): Grada Reshter

- **Mospërputhje në dimensione dhe asimetri:** Pjesa e cila sipas specifikimit teknik duhet të jetë **55 mm**, në produktin e realizuar është **53 mm**. Kjo mospërputhje shkakton devijim dhe asimetri të dukshme vizuale e strukturore, gjë që **tejkalon tolerancën e lejuar prej 1%**

- **Deformim i sipërfaqes (valëzim):** Si pasojë e tërheqjes jo të barabartë të fillit gjatë procesit të qëndisjes, pëlhura/spaleta paraqet valëzim (kurbaturë) dhe nuk është e drejtë.



Lidhur me Pretendimin 5.5 (Mostrat): Grada Toger

• **Asimetri dhe devijim vizual:** Nga pamja vizuale, spaleta paraqet asimetri të theksuar dhe devijim nga forma standarde zyrtare.

• **Qëndisje joproporcionale:** Mbushja e qëndisjes nuk është proporcionale — Janë vërejtur devijime në qendisje, e cila nuk është e drejtë, por paraqitet e pjerrët.

• **Deformim i sipërfaqes (valëzim):** Si pasojë e tërheqjes jo të barabartë të fillit gjatë procesit të qëndisjes, pëlhura paraqet valëzim dhe nuk qëndron e rrafshët e as e drejtë.



Lidhur me Pretendimin 5.6 (Mostrat): Grada Kapiten

- **Asimetri dhe devijim vizual:** Nga pamja vizuale, spaleta paraqet asimetri të theksuar dhe devijim nga forma standarde zyrtare.

- **Mospërputhje në dimensione dhe tejkalim i tolerancës:** Pjesa e kërkuar **40 mm** në produktin e realizuar është **42 mm**, gjë që **tejkalon tolerancën e lejuar prej 1%**

- **Qëndisje joproporcionale:** Mbushja e qëndisjes nuk është proporcionalisht e shpërndarë në njërën anë qëndisja shkon plotësisht deri në skaj (fund), ndërsa në anën tjetër është dukshëm më e ngushtë.

- **Deformim i sipërfaqes (valëzim):** Si pasojë e tërheqjes jo të barabartë të fillit gjatë procesit të qëndisjes, pëlhura paraqet valëzim dhe nuk qëndron e rrafshët e as e drejtë.



Lidhur me Pretendimin 5.7 (Mostrat): Kapiten Spaleta për uniformë Solemne

- **Asimetri dhe devijim vizual:** Nga pamja vizuale, spaleta paraqet asimetri të theksuar dhe devijim nga forma standarde e kërkuar.

- **Qëndisje joproporcionale dhe me defekt meformues:**

  - Pjesa e poshtme e qëndisjes është realizuar në formë **ovale** dhe nuk është e drejtë siç kërkohet sipas specifikimit teknik.
  - Mbushja e qëndisjes nuk është e shpërndarë në mënyrë proporcionale.

- **Devijime në diametra / dimensione dhe tejkalim i tolerancës:**

  - Pjesa e kërkuar **55 mm** në produktin e realizuar është **53 mm**.
  - Pjesa e kërkuar **40 mm** në produktin e realizuar është **42 mm**.
  - Këto devijime dimensionale **tejkalojnë normën e lejuar të tolerancës prej 1%**.

- **Deformim i sipërfaqes (valëzim):** Si pasojë e tërheqjes jo të barabartë të fillit gjatë procesit të qëndisjes, pëlhura paraqet valëzim dhe nuk qëndron e rrafshët.





Lidhur me Pretendimin 5.8 (Mostrat): Grada Major

- **Asimetri dhe devijim vizual:** Nga pamja vizuale, spaleta paraqet asimetri të theksuar dhe devijim nga forma standarde e kërkuar.

- **Deformim i sipërfaqes (valëzim):** Si pasojë e tërheqjes jo të barabartë të fillit gjatë procesit të qëndisjes, pëlhura paraqet valëzim dhe nuk qëndron e rafshët.



Lidhur me Pretendimin 5.9 (Mostrat): Grada Major për uniformë Solemne

• **Asimetri dhe devijim vizual:** Nga pamja vizuale, spaleta paraqet asimetri të theksuar dhe devijim nga forma standarde e kërkuar.

- Pjesa e qëndisjes është realizuar në formë **ovale** dhe nuk është e drejtë siç kërkohet sipas specifikimit teknik

• **Deformim i sipërfaqes (valëzim):** Si pasojë e tërheqjes jo të barabartë të fillit gjatë procesit të qëndisjes, pëllumi paraqet valëzim dhe nuk qëndron e rafshët.



Lidhur me Pretendimin 5.10 (Mostrat): Grada Kolonel

• **Asimetri dhe devijim vizual:** Nga pamja vizuale, spaleta paraqet asimetri të theksuar dhe devijim nga forma standarde e kërkuar.

- Pjesa e poshtme e qëndisjes është realizuar në formë **ovale** dhe nuk është e drejtë siç kërkohet sipas specifikimit teknik.

• **Deformim i sipërfaqes (valëzim):** Si pasojë e tërheqjes jo të barabartë të fillit gjatë procesit të qëndisjes, pëlhura paraqet valëzim dhe nuk qëndron e rafshët.



Lidhur me Pretendimin 5.11 (Mostrat): Grada Kolonek për uniformë Solemne

- **Asimetri dhe devijim vizual:** Nga pamja vizuale, spaleta paraqet asimetri të theksuar dhe devijim nga forma standarde e kërkuar.

    - Pjesët e qëndisjes është realizuar në formë **ovale** dhe nuk është e drejtë siç kërkohet sipas specifikimit teknik.

- **Deformim i sipërfaqes (valëzim):** Si pasojë e tërheqjes jo të barabartë të fillit gjatë procesit të qëndisjes, pëlhura paraqet valëzim dhe nuk qëndron e rrafshët.



Lidhur me Pretendimin 5.12 (Mostrat): Drejtor i Përgjithshëm, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm & Drejtor i Departamentit

- **Asimetri dhe devijim vizual:** Nga pamja vizuale, spaleta paraqet asimetri të theksuar dhe devijim nga forma standarde e kërkuar.

  - Pjesët e qëndisjes është realizuar në formë **ovale** dhe nuk është e drejtë siç kërkohet sipa specifikimit teknik.

- **Deformim i sipërfaqes (valëzim):** Si pasojë e tërheqjes jo të barabartë të fillit gjatë procesit qëndisjes, pëlhura paraqet valëzim dhe nuk qëndron e rafshët.



9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme, si në aspektin financiar, fitimet e munguara, si dhe pamundësia për të kompensuar shpenzimet përgatitore të bëra për këtë kontratë. Ndër shpenzimet kryesore theksojmë:

Shpenzimet për përgatitjen e ofertës;

Pagesa për sigurimin;

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*